



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E MENAXHIMIT TË GARANCIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTËRI I FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 3943/1 Prot.

Tiranë, më 04 / 10 / 2024

Lënda: Mbi raportin e monitorimit për 8 mujorin e vitit 2024.

MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3
Tiranë

Bazuar në ligjin nr.55/2023 "Për Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer", ligjit nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore", shkresës nr. 12140 prot. datë 13.09.2024, e administruar në AMGKP me nr.3943 prot., datë 16.09.2024, është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer për 8- mujorin e vitit 2024.

1. Hyrje

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer, (AMGKP), është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit përgjegjës për financat, i krijuar sipas Ligjit nr. 55/2023, "Për Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer", i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2024.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit për 8-mujorin e vitit 2024 për AMGKP-në përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e AMGKP-së kanë kryer

monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen e objektivave të synuar. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të institucionit në krahasim me planin e miratuar. Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor i mundëson institucionit orientim dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Ky raport do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës institucioni do të synojë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecures të institucionit.

2. Informacioni buxhetor

Në vijim paraqiten plani buxhetor për vitin 2024 i miratuar në fillim të vitit dhe i ndryshuar sipas artikujve.

Tabela nr. 1

E.Q	M.L	Kod inst	Emërtim Institucioni	Kap	Kod.Prog	Llog ekonomike	Kod thesari	Kod produkti	Emertimi i Produkti	Vlera në lekë	Rishikuar me shkresën nr 6597/4	Rishikuar me shkresën nr 9475/6
001	10	1010324	AMGKP	01	01120	600	3535	91002AE	Kontrata të Garancive dhe Kredive të Pakthyera	42,000,000	38,639,000	34,196,000
001	10	1010324	AMGKP	01	01120	601	3535	91002AE	Kontrata të Garancive dhe Kredive të Pakthyera	7,000,000	6,453,000	6,081,000
001	10	1010324	AMGKP	01	01120	602	3535	91002AE	Kontrata të Garancive dhe Kredive të Pakthyera	5,000,000	8,908,000	13,723,000

Me anë të shkresës nr.23989/3 prot. datë 08.02.2024, e administruar në AMGKP me nr.346 Prot, datë 21.02.2024 është dërguar miratimi i detajimit të shpenzimeve korrente për vitin 2024. Artikulli 600 për paga është miratuar në shumën 42,000,000 lekë, artikulli 601 për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është miratuar në shumën 7,000,000 lekë dhe artikulli 602 për mallra dhe shërbime është miratuar në shumën 5,000,000 lekë.

Me shkresën nr 1120 prot., datë 09.05.2024 është bërë kërkesë për rialokim fondi duke qënë se fondi për artikullin 602 ka qënë i pamjaftueshëm për pagesën, regjistrimin dhe mbarëvajtjen e kontratave. Me shkresën 6597/4 prot. datë 13.06.2024 është miratuar transferimi i fondeve buxhetore ku artikulli 600 për paga është 38,639,000 lekë, artikulli 601 për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është miratuar në shumën 6,453,000 lekë dhe artikulli 602 për mallra dhe shërbime është miratuar në vlerën 8,908,000 lekë.

Me shkresën nr 3741 prot., datë 05.08.2024 është bërë kërkesë për rialokim fondi për transferimin e fondeve nga artikulli 600+601 në artikullin 602 në vlerën 4,815,000, duke qënë se AMGKP-ja në 6- mujorin e parë ka patur vende vakante dhe fondi i pagave nuk është shpenzuar.

Tabela nr.2: Raporti përmblledhës i shpenzimeve

Në vijim paraqitet, në mënyrë të përmblledhur, realizimi i fondeve buxhetore për këtë periudhë, nëpërmjet treguesve faktikë me ata të planifikuar.

Në lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor (Plani)	Buxheti 8- mujor (Plani)	Realizimi 8- Mujor (Fakti)	Realizimi në %
Shpenzime Korente	54,000,000	37,502,046	24,994,628	67
Shpenzime Kapitale	0	0	0	0
Totali	54,000,000	37,502,046	24,994,628	67

Shpenzimet korente janë planifikuar për 8 mujorin në shumën 37,502,046 lekë dhe janë realizuar në shumën 24,994,628 lekë ose masën 67%.

Për vitin 2024 nuk janë miratuar shpenzime kapitale.

Në mënyrë analitike, performanca e realizimit të shpenzimeve për këtë periudhë, për AMGKP-në, paraqitet si në vijim:

Tabela nr.3: Realizimi i buxhetit sipas artikujve ekonomikë

Në lekë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor (Plani)	Buxheti i rishikuar (Plani)	Buxheti - 8 mujor (Plani)	Realizimi 8- Mujor (Fakti)	Realizimi në %
600+601	Paga dhe Sigurime	49,000,000	40,277,000	23,879,046	21,212,184	88.83
602	Shpenzime për mallra dhe shërbime	5,000,000	13,723,000	13,623,000	3,782,444	27.77
231	Shpenzime kapitale	0	0	0	0	-
	TOTALI	54,000,000	54,000,000	37,502,046	24,994,628	67

Artikulli 600 dhe 601, "Shpenzime personeli", buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2024 për këtë zë është 49,000,000 lekë, i ndryshuar në shumën 40,277,000 lekë, buxhet i cili do të mbulojë nevojat e institucionit në fushën e pagave për të gjithë vitin, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Plani i buxhetit 8 mujor i detajuar në shpenzime personeli për periudhën Janar-Gusht 2024, është 23,879,046 lekë. Realizimi paraqitet në vlerën 21,212,184 lekë ose 88.83 % të planit 8 mujor. Ka një mosrealizim të planit në vlerën 11.17 % për shkak të vakancave të

pozicioneve të punës si Drejtor i Përgjithshëm, specialist te Sektori i Verifikimit të Kërkesave të Garancive dhe Konfirmimit të Kontratave, Përgjegjës i Sektorit të Ndjekjes të Procedurave Juridike dhe Operacionale dhe punonjës arkivi me kontratë 6 orë/ditë.

Për sa i përket numrit të punonjësve me urdhërin nr.17 datë 25.01.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyesa", numri i punonjësve të AMGKP-së do të jetë gjithësej 30 veta. Gjithashtu me VKM Nr.39, datë 24.01.2024, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore", për institucionin tonë janë miratuar 4 punonjës me kontratë 6 orë.

Mesatarja e plan/faktit për numrin e punonjësve në organikë është 28 persona nga 30 persona gjithësej dhe 3.5 nga 4 persona me kohë të pjesshme 6/ orë në ditë.

Artikulli 602, "Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera", buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull për vitin 2024, është 5,000,000 lekë dhe ndryshuar në vlerën 13,723,000 lekë sipas shkresave të cituara më sipër.

Artikulli 602 për shpenzime mallra dhe shërbime nga 13,623,000 lekë që është planifikuar për 8 mujorin është realizuar në vlerën 3,782,444 lekë ose në masën 27.77 %.

Theksojmë se plani 8 mujor i buxhetit zë 99.27 % të buxhetit vjetor.

Duke qënë se riallokimi i fondeve është bërë në muajin qershor në vlerën 3,908,000 lekë dhe muajin gusht 4,815,000, pritet që në vazhdim sipas kërkesave të kryera nga Sektori i Ndjekjes të Procedurave Juridike dhe Sektori i Procedurave të Ekzekutimit Përmbarimor të kryhen shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2024 në shumën e kërkuar.

Ky nivel do të përmirësohet në periudhën pasardhëse, duke filluar që në muajin Shtator Sektori i Shërbimeve Mbështetëse do të ndryshojë Regjistrin e Prokurimeve me disa zëra si shpenzime kancelari, tonera, materiale pastrimi, mirëmbajtje automjeteve, sigurim objekteve etj.

Synojmë që performanca e realizimit të treguesve të rritet në periudhat në vazhdim dhe të arrihen objektivat buxhetore të institucionit.

Shpenzimet për artikullin 602 kanë qënë shpenzimet elementare për institucionin si energji elektrike, ujë, shpenzime postare, pagesë telefon muaji fiks, taksa bashkie, shpenzime qiraje etj, të specifikuara në tabelën nr 4.

Tabela nr. 4: Shpenzime e artikullit 602 të detajuara

Në lekë

Artikulli 602	Realizimi 8- mujor
Shpenzime shërbime postare	135,195
Shpenzime energji elektrike	203,132
Shpenzime telefoni fiks	26,000
Shpenzime ujë	18,780
Shpenzime të tjera (ASHK, Mirëmbajtje krediti)	362,680
Shpenzime tatim taksa të paguara nga institucioni	45,761
Shpenzime qiraje	2,357,421
Shpenzime transporti (taksa, kualidim)	6,293
Shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga puna	383,760
Shpenzime Dieta	127,000
Shpenzime të sigurimit dhe ruajtjes	80,600
Shpenzime siguracion makine	34,972
Shpenzime gjyqësore	850
TOTAL	3,782,444

3. Arkëtimet nga debitorët e ish- bankave të nivelit të dytë me kapital shtetëror.

Tabela nr.5: Realizimi i arkëtimeve nga debitorët e ish- bankave të nivelit të dytë me kapital shtetëror

Në lekë

Viti	Plan Vjetor	Plan 8 mujor	Fakt 8 mujor	% e Realizimit
2024	80,000,000	50,300,000	21,740,984	43.22

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera një ndër objektivat e saj ka dhe mbledhjen e kredive të ish bankave të nivelit të dytë me kapital shtetëror dhe investimet në banesa nga INSIG sh.a.

Sipas shkresës nr 23022/1 prot. datë 14.02.2024 mbi operimin e llogarive bankare të arkëtimit të detyrimeve të huamarrësit llogaritë ekzistuese në monedhat lekë, euro, usd në emër të kësaj agjencie do të operojnë sipas praktikës të deritanishme për arkëtimet e debitorëve të krijuar para datës 31.12.2023. Agjencia ka llogari rrjedhëse në monedhat lekë, euro, usd në bankat Raiffaisen Bank, BKT, Intesa San Paolo Bank dhe Tirana Bank. Nga bankat janë marrë komisionet në monedhën lekë 8400 lekë, 40 eur dhe 51.7 usd nga muaji Janar-Gusht për mirëmbajtjen e llogarive bankare.

Plani për mbledhjen e arkëtimeve për vitin 2024 për debitorët e transferuar nga ish-bankat me kapital shtetëror dhe Insig është vendosur në shumën 80,000,000 lekë. Ndërsa plani për 8-mujorin e vitit 2024 është 50,300,000 lekë dhe fakti është në vlerën 21,740,984 lekë. Plani është realizuar në masën 43.22 %.

4. Performanca jo-financiare e programit buxhetor

Misioni i AMGKP-së është: Sigurimin e menaxhimit të skemave të veçanta të garancive të huasë dhe trajtimin e kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr.55/2023, "Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera".

Përshkrimi i Produktit: "Mbledhja e detyrimeve të huamarrësve kundrejt Ministrisë së Financave si rezultat i pagesës së garancive dhe detyrimeve të ish bankave me kapital shtetëror".

Qëllimi Politikës së Programit: "Menaxhimin e skemave të veçanta të Garancive të huasë, mbledhjen e detyrimeve të kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre".

Tregues i performancës i projektuar për të matur rezultatin e lidhur me objektivat janë:

1. "Numri i debitorëve të trajtuar duke ezauruar rrugën gjyqësore dhe përmbarimore deri në likuidimin total të detyrimeve".
2. "Numri i kredive të mbyllura në raport me numrin e kredive në trajtim".
3. "Numri i çështjeve të trajtuara për thirrjen e Garancisë si dhe trajtimi i nënhuave".
4. "Përqindja e uljes të portofolit në trajtim".

Detyrat e realizuara

- ✓ Për muajin Janar- Gusht janë bërë 52 praktika mbyllje.
- ✓ Është ulur portofoli në trajtim me 21,740,984 lekë për debitorët e transferuar të ish-bankave të nivelit të dytë.

• Sektori i Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të Veçanta të Garancisë

Objektivat:

1. Kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci nga skemat që ajo menaxhon dhe u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrje,
2. Mban, menaxhon dhe përditëson bazën e të dhënave dhe regjistrin analitik të garancive që menaxhon,

3. Verifikimin e aftësisë paguese të subjekteve huamarrëse për të cilat është kryer pagesa e garancisë në secilën prej skemave të garancive të miratuara, huave dhe nënhuave, të garantuara nga Ministri përgjegjës për financat,
4. Shqyrton dhe analizon raportet periodike të çdo huadhënësi për huatë e aprovuara prej tij dhe çdo informacion dhe dokument tjetër të nevojshëm për monitorimin e ecurisë së garancisë.

Sa më sipër gjatë 4 muorit të dytë të vitit 2024 sektori ka mbikëqyrur dhe monitoruar bankat e nivelit të dytë si më poshtë:

1. Garancia Sovrane 1, kanë ngelur kreditë të pa paguara për 3 subjekte në total 2 banka;
2. Garancia Sovrane 2, monitorohen në total 12 banka të nivelit të dytë ku në total janë 569 subjekte me numër kredie në total 615.
3. Garancia Sovrane 3, monitorohen 3 banka me numër subjektesh në total 7 dhe numër total kredie 11.
4. Garancia Sovrane 4, shqyrtuar aplikimet e ardhura dhe verifikuar disbursimi.

• **Sektori i Verifikimit të Kërkesave të Garancisë dhe Konfirmimit të Kontratave**

Objektivat:

1. Verifikimi i kushteve dhe kriterëve të huamarrjes së institucioneve financiare në zbatim të skemave të veçanta të garancive, të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe të emetuara nga Ministria përgjegjëse për financat.
2. Trajtimi dhe shqyrtimi rast pas rasti i kërkesave të huadhënësve mbi thirrjen e Garancisë, sipas skemave të veçanta të saj, duke verifikuar plotësimin e kushteve për thirrjen e Garancisë, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Konfirmimi i draftit të marrëveshjes së huasë, si dhe verifikimin e përmbushjes së kërkesave të marrëveshjeve të garancisë në tipat e kontratave bankare dhe konfirmimin e këtyre kontratave tip brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës nga institucioni financiar.
4. Ndjekja dhe trajtimi i marrëveshjeve të nënhuave dhe huave buxhetore.

Detyrat e realizuara dhe treguesit e performancës:

1. Janë trajtuar dhe ndjekur 9 raste të thirrjes së garancisë nga Bankat e Nivelit të Dytë, prej të cilave, pas verifikimit të përmbushjes së kushteve sipas Marrëveshjes së Garancisë, është kryer pagesa nga Ministria e Financave në favor të Bankave përkatëse për 4 subjekte.
2. Është trajtuar një kërkesë për refinancim të kredisë brenda skemës së garancisë, e cila pas verifikimit nuk përmbushte kushtet sipas Marrëveshjes së Garancisë.

3. Janë trajtuar 3 raste për të cilat është kryer pagesa nga Ministria e Financave dhe vazhdimisht është kërkuar informacion Bankave lidhur me veprimet e kryera për rekuperimin e detyrimit.
4. Janë dërguar "Njoftim për kthim detyrimi", drejtuar subjekteve për të cilët është kryer pagesa e garancisë nga Ministria e Financave, duke i bërë me dije mbi dispozitat ligjore.
5. Janë trajtuar dhe ndjekur marrëveshjet e nënshkrimit dhe huave buxhetore të marrë në dorëzim nga Ministria e Financave, ku janë dërguar "Njoftim për shlyerje detyrimi", si dhe brenda datës 15 të çdo muaji është rakorduar me Ministrinë e Financave mbi pagesat e kryera nga subjektet dhe detyrimin e mbetur, në përputhje me Udhëzimin nr. 21087 datë 16.11.2023 të Ministrit të Financave.
6. Është marrë në dorëzim nga Ministria e Financave marrëveshja e huasë e lidhur mes Këshillit të Ministrave dhe subjektit Alcontrol sh.a, të cilit i është dërguar njoftim për shlyerje detyrimi nga Sektori.
7. Janë evidentuar problematikat e hasura gjatë punës lidhur me Garancitë Sovrane, për të cilat është përgatitur një Memo, si dhe janë trajtuar 5 subjekte të cilët rezultojnë në vonesë të pagesës së kësteve, por për të cilët Bankat nuk kanë thirrur garancinë.
8. Përgjatë periudhës Janar-Gusht 2024 janë mbledhur dhe derdhur në buxhet totali i detyrimeve si më poshtë:

Për nenhuatë dhe huatë buxhetore:

- Total 6,295,560.40 EUR
- Total 5,120,748.81 USD
- Total 37,523,704.98 ALL

Për kreditë e garantuara:

- Total 5,501,553.59 EUR

• Sektori i Informacionit dhe Administrimit të Dokumentacionit

Objektivat sipas ligjit 55/2023 neni 7 pika c dhe ç:

- c) të rakordojë çdo 3 (tre) muaj të dhënat me huadhënësit dhe ministrinë përgjegjëse për financat;
- ç) të raportojë çdo 3 (tre) muaj në ministrinë përgjegjëse për financat për ecurinë e skemave të garancisë.

Detyrat e realizuara dhe treguesit e performancës:

1. Është raportuar elektronikisht çdo muaj në sektorin përkatës si dhe dërguar shkresë për 3 mujorin e dytë në lidhje me:

- Gjendjen e principalit të paguar,
- Gjendjen e principalit progresiv,
- Stokun për Garancinë Sovrane GS1.GS2.dhe GS3.

• **Spektori i Ndjekjes të Procedurave të Ekzekutimit Përmbarimor**

1. Në zbatim të Urdhërit të brendshëm nr.1091 prot., datë 02.05.2024 "Për evidentimin e urdhërave të ekzekutimit origjinal" nga ana e specialisteve të sektorit të ndjekjes së procedurave të ekzekutimit përmbarimor, është kryer kontrolli fizik i dosjeve të debitorëve për evidentimin e urdhërave origjinal. Më tej, aktet janë përcjellë për ekzekutim pranë zyrave përmbarimore. Sa i përket të rasteve të dërguara për ekzekutim nga ana e specialisteve, konkretisht, vetëm gjatë këtyre katër muajve (periudha maj-gusht 2024), sipas kontrollit të kryer për 1363 dosje, janë përcjellë për ekzekutim 322 Raste.
2. Po kryhet evidentimi i të gjitha pasurive në favor të AMGKP-së me/pa titull pronësie, si dhe është vijuar korrespondenca me ASHK, duke përcjellë 36 shkresa dhe kërkesa për aplikime në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoritë Vendore të saj, për probematikat që Agjencia ka me këtë institucion për pasuritë në pronësi. Shkresat kanë patur për objekt "Kërkesë për informacion, "Plotësim dokumentacioni", "Lëshim kopje karte të pasurisë së paluajtshme", "Informacion zyrtar mbi pasurinë", "Kërkesë për veprim", "Regjistrim sekuestro mbi pasurinë", "Aplikime AV".
3. Janë azhurnuar të dhënat në sistemin e kreditit të AMGKP-së për rreth 344 subjekte debitoare dhe është vijuar intensivisht nga ana e specialistëve verifikimi i dosjeve në arkivë, dokumentacioni i përfshirë në to, kjo për faktin se debitorët janë subjekte të mbartura nga ish institucione shtetërore dhe ka kryesisht mangësi të gjeneraliteteve të këtyre debitorëve.
4. Objektivi për muajt në vijim do të jetë konsolidimi i marrëdhënieve me institucionet e tjera shtetërore, në kuadër të Vendimit nr. 867, datë 10.12.2014 "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore", i ndryshuar me Vendimin nr. 435, datë 26.6.2024, të cilat disponojnë të dhëna në lidhje me debitorët apo pasuritë e tyre të luajtshme apo të paluajtshme, sikurse janë ASHK, DRSHTRR, DPGJC.

• **Spektori i Shërbimeve Mbështetëse**

1. Gjatë 8 muajve të vitit 2024 është ngritur grupi i komisionit të prokurimeve si dhe është krijuar Rregjistri i Parashikimeve në APP për vitin 2024 për një pjesë të procedurave duke ju refuruar dhe fondeve që agjencia kishte në dispozicion. Në bazë të rregjistrit janë realizuar 2 procedura me vlerë nën 100,000 lekë. Konkretisht "Blerje

kamera dhe sisteme alarmi” me vlerë 80,600.40 (tetëdhjetë mijë e gjashtëqind pikë dyzet) lekë me TVSH, dhe “Paisje të automjeteve “HUNDAI ACCENT” me targë AA 516 TF dhe AA 517 TF me siguracion (TPL)” me vlerë 34,972 (tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë me TVSH.

• **Sektori i Ndjekjes të Procedurave Juridike dhe Operacionale**

1. Nga ana e sektorit të Ndjekjes së Procedurave Juridike dhe Operacionale janë ndjekur procedurat për kthimin e kredive për kreditë e transferuar nga bankat e nivelit të dytë me kapital shtetëror.
2. Në kuadër të procedurave për kthimin e këtyre kredive nga ana e sektorit janë dërguar 1739 “Njoftim për shlyerje detyrimi”, janë përgatitur 42 kthim përgjigje për kërkesat e ndryshme të debitoreve, janë përgatitur 3 deklarata mbrojtje si dhe janë ndjekur 86 seanca gjyqësore në rrethe të ndryshme të Shqipërisë.
3. Vlen për tu theksuar se gjatë 4 mujorit të parë ritmi i punës ka qënë i ulët për shkak të ndryshimeve ligjore. Po që nga fillimi i muajit që situata ligjore është rregulluar nga ana e sektorit të Ndjekjes së Procedurave Juridike dhe Operacionale ka filluar puna në ritme të larta për të arritur objektivat e Agjencisë dhe për të kryer mbledhjen e kredive sipas ligjit në fuqi.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Agjencia e Shërbimeve

